

**AKT I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUTIZUAR
"Cyberfarm" SHPK**

Sot më date 11.02.2025, në Tiranë, u paraqiten personalisht ortakët themelues si me poshtë:

1. **Z. Kushtrim Shala**, i biri i Myftar-it, shtetas shqiptar, lindur 01.04.1981, në Gjakovë Kosovë, banues ne Tiranë, Rr. Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Pallati 8, Shkalla 2, Ap. Nr. 29, Tirane, Shqipëri, me Letërnjoftim ID me nr. personal I10401259H, madhor e me zotësi te plotë juridike për te vepruar;

Dhe

2. **Z. Ermal Beqiri**, i biri i Nexhmi, shtetas shqiptar, lindur me 23.01.1982, në Gjirokastër Shqipëri, banues ne Tiranë, me Letërnjoftim ID me nr. personal I20123025V, madhor e me zotësi te plete juridike e për te vepruar;

Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe ne përputhje me Ligji Nr. 9901, Dt. 14_04,2008 "Për Tregtare dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Akt Themelimi të Shoqërisë tregtare "Cyberfarm" Sh.p.k. e cila ka formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (sh,p,k),, si një Shoqëri e së drejtës shqiptare si vijon:

**Neni 1
Forma e shoqërisë**

Ortakët theksojnë se Shoqëria e themeluar do të jetë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.), në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

**Neni 2
Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "Cyberfarm" sh.p.k.

**Neni 3
Baza juridike**

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, si dhe në përputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit të Themelimit.

**Neni 4
Objekti i veprimtarisë**

4.1 Objekti i veprimtarisë të Shoqërisë tregtare "Cyberfarm" sh.p.k është si më poshtë:

a) CyberFarm, do të ushtrojë veprimitari në ofrimin e trajnimeve elitare për sigurinë kibernetike dhe teknologjitet e avancuara të përshtatura për profesionistët e nivelit të lartë, klientët tanë si korporatat, kompanitë dhe institucionet. Programet tona shkojnë përqej trajnimit standard, duke ofruar ekspertizë strategjike dhe praktike që rrit sigurinë organizative dhe aftësitë dixhitale.



b) Ushtrimin e veprimtarise se trajnimit duke u bazuar në teknologjitetë ekzistuese dhe në zhvillimet bashkohore të lidhura me Sigurinë Kibernetike, Inteligjencën Artificiale, Ueb3, IoT (Internet of things), Blockchain, e të tjera në vijim:

- Organizimi i kurseve te formimit profesional te njohurive te per gjithshme dixhitale ne Republikën e Shqipërisë;
- Organizimi i kurseve te formimit profesional te IT –se ne Republikën e Shqipërisë;
- Organizimi i kurseve te formimit profesional te Sigurise Kompjuterike ne Republikën e Shqipërisë;
- Organizimi i kurseve te formimit profesional te inxhinierise softuer-ike ne Republikën e Shqipërisë;
- Organizimi i kurseve te formimit profesional te Sistemeve te ndryshme Operative – Softuer-ike ne Republikën e Shqipërisë;
- Kryerjen, menaxhimin, ofrimin dhe organizimin e te gjithe veprimtarise edukative ne forme ligjore dhe tregtare sipas parashikimeve ligjore qe permban Legjislacioni Shqiptar;
- Kryerjen, menaxhimin dhe ofrimin e procesit te ndërmjetësimit midis punedhenesve dhe punemarrësve ne raport me profesionistet e rinj dhe ata ekzistues te Teknologjisë se Informacionit dhe Komunikimit.
- Kultivimi i talentit kryesor. Ashtu si një fermë ushqen të farat më të mira, ne kultivojmë profesionistë të sigurisë kibernetike të kalibrit të lartë.
- CyberFarm qëndron për sofistikimin, dhe edukimin me vlerë të lartë - duke ripozicionuar klientët tanë si kompanitë, korporatat dhe institucionet përmes njohurive në sigurinë kibernetike dhe trajnimet e teknologjive të avancuara.

4.2 Shoqëria ka te drejte te hap filiale brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë.

Neni 5

Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë "Cyberfarm" sh.p.k është në adresën: Rr. Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Pallati 8, Shkalla 2, Ap. Nr. 29, Tirane.

Neni 6

Kohëzgjatja

Shoqëria do te ushtroje veprimtarinë e saj për një periudhe te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne QKB.

Neni 7

Kapitali i Shoqërisë

7.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 200,000 (dyqind mijë) Lek, i investuar ne masë plotë prej ortakëve Kushtrim Shala dhe Ermal Beqiri, në cilin Kushtrim Shala ka investuar në masën 102,000 (njëqind e dy mijë lekë) Lek, ndersa Ermal Beqiri ka investuar masën e 98,000 (nëntëdhjetë e tetë mijë) Lek.

7.2. Kapitali themeltar është i ndarë në 2 kuota.

7.3. Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë e secilit ortak themelues është si më poshtë:



- Kushtrim Shala zotëron 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kuotave të shoqërisë;
- Ermal Beqiri zotëron 49% (dyzetenëntë për qind) të kuotave të shoqërisë.

Neni 8 Organet drejtuese

Organet Drejtuese të Shoqërisë

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, e cila përbëhet nga ortakët.
- Administratori.

Neni 9 Administrimi

9.1 Administrator i Shoqërisë caktohet për herë të parë për një periudhë 4 vjeçare Z. Kushtrim Shala, i biri i Myftar-it, shtetas shqiptar, lindur 01.04.1981, në Gjakovë (Kosovë), banues ne Tiranë, Rr, Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Pallati 8, Shkalla 2, Ap. Nr. 29, Tirane, Shqipëri, ID me nr. personal I10401259H, madhor e me zotësi te plotë juridike për te vepruar;

9.2 Afati i mandatit te administratorit fillon me regjistrimin e shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe ka një kohëzgjatje prej 4 vitesh, me te drejt rizgjedhjeje.

9.3 Administratori ka te gjitha kompetencat, te cilat i deklaron se i njeh dhe i pranon, per te kryer te gjitha detyrimet qe lindin ne baze te statutit te shoqërisë dhe ne mënyre te veçante nga ligji tregtar ne fuqi.

Neni 10 Dispozita te tjera

10.1 Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit, qoftë ndërmjet ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet Shoqërisë dhe palëve të treta, do të zgjidhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Gjykata kompetente për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ky Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhen shqipe me fuqi të njëjtë ligjore dhe janë nënshkruar rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

Z. Kushtrim SHALA

Kushtrim Shala
781.

Z. Ermal BEQIRI

Ermal Beqiri
781.